

Mungesa e përgatitjes në fushat politike, ekonomike, shoqërore, apo në atë të arsimit kurrë nuk duhet të merret si pretekst për të vonuar pavarësinë. (Rezoluta 1514 e OKB-së, më 1960)

VETËVENDOSJE!
<http://www.vetevendosje.org>

Fletushkë e Lëvizjes VETËVENDOSJE!

KËTË JAVË:

**Provokimet e dhunshme të Serbisë
Për çka të jemi të përgatitur në vitin
2009?**

**Fragment nga 'Padrejtësia e
stabilitetit,' shkruar nga Albin Kurti**



Një shitore e djegur shqiptare në Mitrovicë,
2 januar 2009

Provokimet e dhunshme të Serbisë
Gjatë disa javëve të shkuara, Serbia ka zbatuar një sërë masash në përpjekje të provokimit të dhunës në Kosovë dhe për ta bindur bashkësinë ndërkombëtare për domosdoshmërinë e negociatave të mëtutjeshme. Kjo është faza tjetër e strategjisë së vazhdueshme të Serbisë të përdorimit të agresionit për t'i realizuar qëllimet e veta. Kjo ka pasur sukses gjatë vitit të kaluar ngase, bashkësia ndërkombëtare, duke pasur frikë nga potenciali destabilizues i Serbisë, i është përgjigjur agresionit me plotësim dëshirash. Kur qeveria e ashtuquajtur 'e moderuar' e Serbisë përdorë politika të agresionit, bashkësia ndërkombëtare ka frikë se një politikë ndëshkuese do t'u hapte rrugën nacionalistëve të skajshëm të Serbisë.

Deri tash Serbia i ka përqendruar provokimet e saj në pakicën e vogël shqiptare në veri të Mitrovicës dhe në ish ushtarët e UÇK-së. Së pari më 26 dhjetor, pjesëtarët e xhandarmërisë serbe arrestuan dhjetë ish ushtarë të UÇK-së në Luginën e Preshevës, nën akuzat e trilluara se kishin kryer krime gjatë luftës në Gjilan para dhjetë vjetësh. Ky ishte arrestim politik dhe pjesë e një plani më të gjerë për të krijuar frikë dhe për ta destabilizuar Kosovën. E dyta, strukturat paralele të Serbisë e kanë shtuar intensitetin e sulmeve ndaj shqiptarëve, të cilët ende jetojnë në veri të qytetit të Mitrovicës. Dy të rinj shqiptarë u

arrestuan për shkak se kishin përdorur thika për ta mbrojtur veten nga një grup serbësh. Pas kësaj, me qindra serbë protestuan nëpër rrugë, duke thënë se ky kishte qenë një sulm i nxitur nga shqiptarët. Më vonë, derisa pjesëtarët serbë të Shërbimit Policor të Kosovës shikonin duarkryq, serbët i dogjën dy shitore të shqiptarëve dhe u aktivizuan disa bomba.

Nuk ka njësi të policisë speciale të Kosovës në Mitrovicë për t'u ndihmuar shqiptarëve. Në vend të kësaj, populli duhet të bazohet në oficerët e KFOR-it dhe të EULEX-it, të cilët paraqiten pasi gjithë këto veprime kryhen gjatë natës për të njohtuar se situata është nën kontroll. Siç tha një nga shqiptarët a atyshëm, po t'i kishte ndodhur kjo një pjesëtar të komunitetit serb, Ban Ki-moon-i do të ftonte mbledhje speciale të Këshillit të Sigurimit!

Për çka të jemi të përgatitur në 2009-tën

- Zbatimin e Gjashtë Pikave në të gjitha zonat e banuara me serbë
- Më shumë negociata në mes të UNMIK-ut dhe Serbisë rreth Kosovës
- Ngacmimin e vazhdueshëm të shqiptarëve në veri të Mitrovicës
- Krijimin e komunave të reja me shumicë serbe përmes decentralizimit
- Zbatimin e Zonave të Veçanta rreth monumenteve ortodokse
→ **Ndarjen totale institucionale dhe etnike të Kosovës**

Fragment nga 'Padrejtësia e stabilitetit,' nga Albin Kurti

"Prania ndërkombëtare është sundim ndërkombëtar dhe ajo bazohet në paradigmen e stabilitetit. Ajo kujdeset që gjendja të mbetet stabile. Në fjalorin e tyre nuk janë fjalët: demokracia, zhvillimi dhe liria, por fjalët: stabiliteti dhe siguria. Pra, ata kujdesen që gjendja të mos ndryshojë; ata janë investim në *status quo* për hir të *status quo*-së. Këto nëntë vjet e gjysmë me Kosovën e ndarë përbrenda dhe pa zhvillim ekonomik janë dëshmi për

Nr.128, 5 janar 2009

këtë. Jorastësisht EULEX-i e definon veten si "operacion për menaxhimin e krizës": Kosova është krizë, ajo do të mbetet krizë, porse kjo krizë duhet menaxhuar dhe këtë gjë s'e bën dot Kosova vetë por duhet ta bëjë operacioni i quajtur EULEX. Menaxhimi i krizës ka kuptimin e parandalimit të shpërthimit të krizës dhe jo të eliminimit të saj apo të shkaqeve të saj. Kjo nuk do të thotë që ata besojnë se nuk mund ta eliminojnë krizën, por kjo do të thotë që ata nuk e kanë për mision eliminimin e krizës – edhe EULEX-i udhëhiqet nga paradigma e stabilitetit. EULEX-i si "operacion për menaxhimin e krizës" shpërfaq se si na sheh Brukseli neve: si një vend ku kemi gjendje të jashtëzakonshme, që i nevojitet një regjim policor (me fuqi ekzekutive dhe imunitet nga ndjekjet penale). Kur flasin për sundimin e ligjit, flasin si sundimtarë të ligjit – nuk i zënë aq në gojë drejtësinë dhe të drejtat por stabilitetin dhe vetëm stabilitetin.

Stabiliteti si paradigmë bën që siguria për të cilën flet bashkësia ndërkombëtare të jetë siguri joekonomike. Siguria ka qenë fjala që më së shumti është përmendur prej KFOR-it. Ushtria ndërkombëtare nuk ka folur për mbrojtjen e Kosovës, por për sigurinë brenda saj, pra më parë si një polici sesa si një ushtri. Me ardhjen e EULEX-it vetëm sa sqarohet natyra policore e prezencës ndërkombëtare në Kosovë...

Paradigma e stabilitetit bën që siguria të jetë siguri e pushtetarëve atje lart, e jo e qytetarëve poshtë, siguri e marrëdhënies dhe hierarkisë ekzistuese politike, siguri që nuk lidhet me mirëqenien dhe perspektivën e qytetarit por me numrin e forcave të armatosura të sigurisë. Natyrisht, qysh në fillim, faktorët ndërkombëtarë nuk kanë ardhur në Kosovë për ta çliruar e zhvilluar Kosovën, por për ta ndaluar luftën. Ata kanë bërë luftë për ta ndaluar luftën, dhe janë vendosur në Kosovë për të mos e lejuar rishfaqjen e saj. Mirëpo, nëse kjo mënyrë e ka penguar shpërthimin e një konflikti të ri, ajo gjithnjë na ka mbajtur në prag të tij."